

Nr. 3685/ Prot

Dt. 15.07.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.445/1prot.

Shkodër, më 12.07.2022

**LËNDA: Mbi vendimin Nr.41, datë 27.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, në mbështetje të nenit 18, neni 23, neni 54/k, neni 55/3, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, VKM Nr.1096 dat.28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike”, materialit të dërguar nga sekretari i këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.3690 prot, datë 4.07.2022 të mbledhjes së këshillit të bashkisë Vau-Dejës të datës 27.06.2022”, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës nr.41 datë 27.06.2022** “Mbi miratimin e rregullores së brendshme për shfrytëzimin e hapësirave publike për Bashkinë Vau-Dejës”.

Pas analizimit, Prefekti ju autorizon të procedoni, sipas korrigjimeve të mëposhtme:

Neni 14, shkronja “c” e rregullores objekt trajtimi, terminologjia është e pasaktë, pasi Kryetari i Bashkisë është subjekti që nënshkruan një akt administrativ pas përgatitjes nga sektori ligjor, *tregoni kujdes,*

Neni 18 i rregullores shprehet për gjoba, të cilat janë pjesë e VKB Vau-Dejës Nr.65 datë 26.11.2021 “Për miratimin e gjobave për vitin 2022”, për të cilin Prefekti është shprehur,

Neni 22 ka pasaktësi për arsye se një vendim i këshillit bashkiak ndryshohet, korrigjohet apo plotësohet vetëm me një tjetër vendim të KB, jo me vendim të organit ekzekutiv.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KESHILLI BASHKIAK**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vau Dejes, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**VENDIM**

**Nr.41 Date : 27 / 06 / 2022**

**PËR**

**“Miratimin e Rregullores së Brëndshme për shfrytëzimin e hapësirave publike“**


Në mbështetje të ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar. Ligji nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, Ligjit nr 107/2014 “Për Planifikimin Dhe Zhvillimin Të Territorit” i ndryshuar, Ligji 9632 date 30.10.2006 i ndryshuar, VKM nr 1096 date 28.12.2015 “ Per miratimin e rregullave dhe Proçedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike, VKB Nr. 71. Date 26.11.2020 “ Per Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejes , ndryshuar, si dhe në Vendimin e kryetarit të Bashkisë Vau Dejes Nr. 15 date 18.05.2022 me Nr Prot 2989 date 18.05.2022 Vendim për “Miratimin e Rregullores së Brëndshme për shfrytëzimin e hapësirave publike“.

**Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave,**

**VENDOSI**

- Të miratojë “Rregulloren e Brëndshme për shfrytëzimin e hapësirave publike“, bashkëlidhur rregullorja.
- Kjo rregullore do të shërbejë Bashkisë Vau Dejës të menaxhojë hapësirat publike , tu japë mundësi bizneseve që janë të interesuar për vendpikime të personalizuara , si dhe shitësve ambulantë që kanë paraqitur kërkesë për t'u nënshtruar proçedurave të rregullta të cilët do të tarifohen sipas VKB Nr. 71. Date 26.11.2020 “ Per Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejes , ndryshuar .
- Kërkesat për shfrytëzim të hapësirave publike të cilat nuk janë të pasqyruara në këtë rregullore do të reflektohen në varësi të kërkesave dhe pas studimit nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike do të paraqiten para Këshillit Bashkiak Vau Dejës për shqyrtim dhe miratim.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar,(Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore), Drejtoria Juridike dhe Sektori i Aseteve, Administratoret e Njësive Administrative dhe Policia Bashkiake.
- Ky vendim i njoftohet Prefektit të Qarkut Shkoder.

- Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”(ndryshuar)
- Ky Vendim u shpall sot me datë 04/07/2022.



SEKRETAR

ARDIAN CELEPIJA



KRYETAR

MARK BISHA

Miratur me 19 vota

Vota pro 19

Vota kunder -

Vota abstenim -

Zbardhur me date 04/07/2022



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA VAU DEJES**

---

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.*

**RREGULLORE**

**“PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE”**

**Baza Ligjore**

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ndryshuar.

Ligji Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar.

Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”;ndryshuar.

VKM. Nr. 1096 date 28.12.2015 “Per miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”;

Ligji nr. Nr. 8744, date 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore; VKB Nr. 71. Date 26.11.2020 “ Per Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejes , ndryshuar.

**Neni 1**

**Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kushtet e procedurat për përdorimin, shfrytëzimin dhe menaxhimin e hapësirës publike si vend parkimeve shitës ambulant apo kioska për ofrim shërbimi sezonal.

**Neni 2**

**Objekti**

Objekt i kësaj rregullore janë haëasirat e lejueshme për vend parkime, shitës ambulant apo kioska të cilat do të tarifohen nga Bashkia Vau Dejes.

**Neni 3**  
**Përkufizime**  
**Hapësira Publike**

Hapësire publike, është hapësira e jashtme, si trotuari, sheshi, lulishtja, parku dhe te tjerë të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jete publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugë kalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht regjimit juridik të tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas Ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe Vendim nr.3 KKT dt 27.04.2018 "Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau Dejës

**Neni 4**  
**Përdorimi i hapësirave publike**

Hapësira publike është prone e përbashket, që i përket komunitetit ku jetojmë, dhe të gjithë në jemi të barabartë kundrejt përdorimit të saj. Është e ndaluar zënia e hapësirës publike në mënyrë të përkohshme edhe përhershme, me çfarëdo lloj objekti, mbi ose nën të, pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.

**Neni 5**  
**Leje e Shfrytëzimit**

- a) Lejet e shfrytëzimit të hapësirave publike jepen për një periudhë jo më të vogël se 6 muaj dhe jo më të madhe se 1 vit, dhe kanë të drejtë rinovimi.
- b) Lejet e shfrytëzimit të hapësirave publike jepen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

**Neni 6**  
**Rregullat e shfrytëzimit të hapësirës për publike**

Subjekti, në përputhje me rregulloren dhe ligjet në fuqi, duhet të shfrytëzojë hapësirën publike, sipas miratimit të bërë.

- a) duhet të riparojë me shpenzimet e veta të gjitha dëmtimet që rezultojnë nga përdorimi ose keqpërdorimi i hapësirës publike të dhënë;
- b) të sigurojë, me shpenzimet e veta dhe në kushte optimale sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim dhe atë rreth saj si nga ana e pastërtisë dhe funksionalitetit;
- c) të kujdeset që objektet e vendosura në sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim të jenë në gjendje të mirë si nga ana funksionale dhe ajo estetike;
- d) të përdorë hapësirën publike në mënyrë të tillë që të mos kufizojë, shkaktojë dëm ose të shkele të drejtat e paleve të treta;
- e) të shmangë krijimin e situatave të rrezikshme ose të pengimit të qarkullimit të

mjeteve dhe kalimit te kembesoreve;

f) te mos shfrytezoje hapësire me te madhe se fasada e ambjentit qe ai disponon;

g) te beje pagesen e tarifës brenda afatëve te percaktuara;

h) ne momentin qe subjekti nuk ka me te drejte per shfrytezimin e hapësirës publike si rrjedhoje e mos zbatimit te detyrimeve ose nepermjet kerkeses se tij, ta ktheje kete hapësire ne gjendje funksionale sic ishte para marrjes ne dorezim;

## **Neni 7**

### **Shfrytëzimi i hapësirave publike për tregtimin e artikujve të ndryshëm**

Shfrytezimi i hapësirës publike, per tregtimin e artikujve te ndryshem, biznese te tjera te ngjashme apo shites ambulant, lejohet, si me poshte:

a) Perdorimi i hapësirës nga shitesit ambulant, lejohet vetem ne rastet kur ato jane te grupuar ne tregje, ne hapësira te percaktuara nga pushteti lokal.

b) Nuk lejohet vendosja e kioskave, pervec vendeve te percaktuara nga autoriteti vendor.

c) Aprovimi i vendodhjes do shoqerohet me modelin e kioskes respektive si dhe detyrimet qe perfituesi do te kete, per perdorimin e kesaj hapësirës publike.

d) Keto biznese (dyqan, tregtimi i artikujve te ndryshem, biznese te ngjashme) jane te detyruara te kryejne veprimtarine e tyre, brenda hapësirës, ambjentit qe zoterojne, (kane ne perdorim), duke mos cenuar ne asnje menyre, hapësiren publike.

e) Ekspozimi i produkteve te tregtuara, duhet te behet vetem brenda fasades se ambjentit, ku biznesi ushtron aktivitetin dhe jo jashte saj.

f) Gjithashtu per cdo element te shtuar te fasadave respektive, qe eshte pjese e hapësirës publike, sikurse tenda, cadra, reklame etj, nevojitet leje nga autoritetet perkatese.

## **Neni 8**

### **Dokumentet e kerkuara, për fillimin e procedurave, për dhenien e lejes së shfrytetimit së hapësirës publike**

1. Subjektet e interesuara, duhet te paraqesin ne Zyren me nje ndalesë (ZIN) dokumentet e meposhtme;

a) Fotokopje te mjetit identifikues Kerkese per paisjen me leje shfrytezimi prane ZIN Bashkia Vau Dejes.

b) Certifikaten e regjistrimit te subjektit;

c) Vertetim qe subjekti nuk ka detyrime vendore;

d) Dy foto ne kendet e ndyshme te hapësirës ku te kuptohet si fasada e ambjentit si dhe hapësira para saje (trotuari).

1. Ne rastet kur aplikimi per pajisje me leje shfrytezimi te hapësirës publike ka mangesi ne dokumentacion, leja refuzohet.

2. Kërkesat paraqiten prane zyres me nje ndalese, prane Bashkise Vau Dejes.
3. Subjekti paiset me leje shfrytzimi, pasi te kryeje detyrimet e pagesave per hapesiren te cilen kerkon te marre ne shfrytezim.

#### **Neni 9**

##### **Afatet**

- a) Bashkia Vau Dejes del me vendim Brenda 10 diteve per dhenien apo jo te shfrytezimit te hapesirave publike.
- b) Afati 10 ditor perjashtohet atehere kur kerkuesi nuk ploteson detyrimet financiare dhe ne rastet kur zonat e kerkuara nuk jane zona me studime plani.

#### **Neni 10**

##### **Detyrat e drejtorise e studimeve planifikimit, kordinimit të investimeve**

Drejtoria E Planifikimit Te Territorit Dhe Investimeve Publike realizon planin e shfrytezimit te hapesires publike ne te gjithë territorin e Bashkise ose ne nje pjese te saj te specifikuar ne kete rregullore dhe qe nuk bie ne kundërshtim me te.

Ne rastet kur paraqiten kërkesa per shfrytezimin e hapësirave publike ne zona qe nuk jane perfshire ne plane, Drejtoria e Planifikimit te Territorit dhe Investimeve Publike merr ne shqyrtim brenda 15 diteve kërkesat dhe ne rast kur kërkesa nuk bie ne kundërshtim me ligjet ne fuqi dhe kete rregullore i propozon Kryetarit te Bashkise qe kjo zone te perfshihet ne planin e shfrytezimit te hapësirave publike.

#### **Neni 11**

##### **Detyrat e Drejtorise Juridike dhe Sektorit te Aseteve**

Drejtoria Juridike dhe Sektori i Aseteve , pas miratimit me Vendim te Keshillit Bashkiak dhe aprovimit te Prefektures se Qarkut Shkoder hartojne kontarten tip per dhenien e lejes se shfrytezimit te hapesires publikje.

Ne vijim Sektori I asetëve shqyrton kërkesen, nese kjo kërkesë është ne perputhje me kete rregullore dhe ligjet ne fuqi I propozon kryetarit te Bashkise te dale me Vendim per lidhjen e kontrates me subjektin e interesuar.

Dhenia e lejes permban : Vendimin e Kryetarit te Bashkise, Aktet e pageses se tarifës dhe Kontraten perkatese.

Ne momentin e dhenies te lejeve te shfrytezimit, përcillet dhe u komunikohet zyrtarisht administratoreve te njesive administrative ku jepet leja dhe Policise Bashkiake.

#### **Neni 12**

##### **Detyrat e Dejtorisë së të ardhurave**

- a) Drejtoria e te ardhurave verifikon qe nuk është debitor per detyrimet vendore.
- b) Drejtoria e te ardhurave faturon detyrimet per hapesirat dhe siguron qe fatura te shlyhet perpara dhenies se lejes se shfrytezimit.

### **Neni 13**

#### **Detyrat e Administratorëve të Njesive dhe Policisë Bashkiake**

- a) Administratorët e Njesive Administrative dhe Policia Bashkiake do të sigurojnë që subjektet të zbatohen me korrektesë sipërfaqen të cilën kanë marrë në përdorim.
- b) Administratorët e Njesive Administrative raportojnë pranë kryetarit për çdo rast të zënies së hapësirave publike në mënyrë jo të ligjshme.
- c) Mos kryerja e detyrimeve konsiderohet shkelje e rëndë për, Administratorët e Njesive Administrative.
- d) Policia Bashkiake ka për detyrë të jetë në çdo rast në mbështetje të inspektorëve të taksave në rastet kur këta të fundit e shohin të nevojshme prezencën e saj.
- e) Policia Bashkiake në rastet e shkeljeve të lejes së shfrytëzimit të hapësirave publike ka detyrën të lirojë sheshet dhe hapësirat publike.
- f) Policia bashkiake aplikon gjobat për çdo subjekt apo individ në rastet e shkeljeve të konstatuara nga ana e këtyre të fundit e vendodhjes.

### **Neni 14**

#### **Marreveshjet**

- a) Marreveshja të cilat do të lidhen mes subjektit kërkues dhe Bashkisë Vau Dejës, ka si qëllim përcaktimin e kriterëve të bashkëpunimit në fushën e ruajtjes, mirëmbajtjes dhe shërbimit të hapësirave publike në shfrytëzim dhe përreth zonave në të cilën ushtrojnë aktivitetet.
- b) Kjo marreveshje bëhet sipas rëndësisë së zonave dhe kategorive të përcaktuara në këtë rregullore.
- c) Modelet tip të marreveshjeve përcakton me vendim të kryetarit të Bashkisë. *VKB Nr. 71. Datë 26.11.2020 "Për Miratimin e Paketës Fiskale Bashkia Vau Dejës, ndryshuar."*

### **Neni 15**

#### **Mbajtja e dokumentave**

Subjekti i paisur me lejen e shfrytëzimit duhet të mbajë dokumentet në ambientet që ushtrojnë aktivitetin. Mos mbajtja e dokumenteve në mënyrë të përsëritur konsiderohet si shkelje dhe gjobitet me gjobe. Përsëritja në mënyrë të vazhdueshme e shkeljes bëhet shkak për heqjen e lejes së shfrytëzimit.

### **Neni 18**

#### **Sanksionet**

1. Në momentin e konstatimit të zënies së hapësirave publike, subjekti gjobitet me gjobe sipas kundrvajtjes përkatëse në vlerën:
  - a) Ekspozim Malli - 10 000 leke
  - b) Veprimtari të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike – 5 000 leke
  - c) Shërbim me tavolinë jashtë lokalit - 5 000 leke.



**Neni 19**  
**Specifikime dhe plan vendosje**

Specifikimi i distancave, vendeve, menyrave korrekte, te lejuara te shfrytezimit te hapësirës publike, ilustrohen, shpjegohen me skicat perkatese.

**Neni 21**  
**Miratimi i hapësirës publike**

1. Miratimi i hapësirës publike behet bazuar ne planin ne legjislacionin perkates dhe ne PPV Vendim nr.3 KKT dt 27.04.2018 "Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau Dejës.
2. Per ndryshimin dhe miratimin e ketij plani per shfrytezimin e hapësirave publike behet me vendim te kryetarit te bashkise.

**Neni 22**  
**Anekset**

Shtesat dhe ndryshimet ne kete rregullore behen me vendime te Kryetarit te Bashkise dhe quhen aneks i kesaj rregullore.

**KRYETARI**  
**MARK BABANI**

*Hartoi grupi I punes:*

*Dorina Lekaj – Jurist*

*Ana Shurdha - Arkitekt*

*Olta Velaj – Ing. Topograf*

